VENDIM
Nr. 256, datë 23.8.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "GEALB ENERGY" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET "GURI I BARDHË 1" ME FUQI TË INSTALUAR 5360 kw DHE "GURI I BARDHË 2" ME FUQI TË INSTALUAR 3940 kw, ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 9300 kw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a" dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2042/1 prot., datë 21.8.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë 'Gealb Energy' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet 'Guri i Bardhë 1' me fuqi të instaluar 5360 kw dhe 'Guri i Bardhë 2' me fuqi të instaluar 3940 kw, me fuqi totale të instaluar 9300 kw, në pellgun ujëmbledhës të përrenjve të Zallit të Dishit dhe të Shehut (degë e lumit Mat), fshati Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër, Bashkia Klos, qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 9300 kw",

konstatoi se:

- Shoqëria "GEALB ENERGY" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2042 prot., datë 17.8.2023, paraqiti aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet "Guri i Bardhë 1" dhe "Guri i Bardhë 2", me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përrenjve të Zallit të Dishit dhe të Shehut (degë e lumit Mat), fshati Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër, Bashkia Klos, qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 9300 kw.

- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e licencimit, sipas përcaktimeve të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria "GEALB ENERGY" sh.p.k. ka plotësuar, në zbatim të përcaktimeve të rregullores, dokumentacionin për nenin 9, pikën 1.1, germat: "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat: "a", "c" dhe "d", si dhe për pikën 2, germat: "a", "d", "e" dhe "f".

- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

Neni 9, Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2, Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa "b": të depozitojë vërtetimin e gjendjes gjyqësore nga Drejtoria e Burgjeve për administratorin dhe shoqërinë "Glealb Energy" sh.p.k.

Pika 1.3, Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa "a": të vërtetojë që nuk ka detyrime në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore;

- germa "b": të sjellë letër interesi të rinovuar në afate, që reflekton interesin e bankës për financimin e këtij investimi, duke saktësuar normën e financimit, ose të dokumentojë/informojë në ERE nëse shoqëria ka nënshkruar ndonjë marrëveshje me bankën apo kontratë financiare, origjinale/të njësuar me origjinalin;

- germa "c": të depozitojë planin e biznesit në format origjinal/ose fotokopje të njësuar me origjinalin.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE shtojcën 2 të plotësuar:

- germa "b": të depozitojë në ERE, kontratën e koncensionit, amendimin e kontratës dhe kontratën shtesë në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin;

- germa "c": të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar/marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "GEALB ENERGY" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet "Guri i Bardhë 1", "Guri i Bardhë 2", në rrjedhën e përrenjve të Zallit të Dishit dhe të Shehut (degë e lumit Mat), fshati Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër, Bashkia Klos, qarku Dibër, me kapacitet të instaluar 9300 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti